



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.387 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkimit Demokratik (BD) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), dega në Prizren, për shkak të mbulimit të posterave të subjektit politik BD , për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Bashkimi Demokratik (BD), dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.10.2013, nga subjekti politik bashkimi Demokratik (BD) dega në Prizren, me të cilën pretendohet se në Lagjen Jenimall është bërë dëmtimi dhe mbulimi i posterave nga subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi, me çka edhe ka bërë shkelje të LZP-së përkatësisht neni 33 pika a.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, nëpërmjet emailit e informoi subjektin politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, se më datë 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 02.11.2013.

PZAP-i, e mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) sipas afatit të caktuar, ku subjekti politik KTAP mohon pretendimet e ankuesit dhe thekson se ankesa e bërë kundër subjektit tyre nuk ka bazë dhe nuk është e vërtet. KTAP në përgjigjen ofruar potencon se janë një parti sapo e formuar dhe duke marr parasysh sekuencat dhe dënimet me kujdes të veçantë kemi vepru në teren, andaj plotësisht hedhim poshtë shpifjet e partisë Bashkimi Demokratik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore te palës ankuese PZAP-i,i konsideron se janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, sepse nga dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk janë dëshmi bindëse me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk janë të mjaftueshëm për të vërtetuar kryesin e supozuar të shkeljes. Andaj PZAP-i ,konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar

në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 387/2013 më datën 04.11.2013

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*